

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: AL Engineering SH.P.K., MUJË KRASNIQI C7 H11 NR. 14 – PRISHTINË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	29.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **27.03.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **AL Engineering SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MBIKËQYRJA E INVESTIMEVE KAPITALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-363-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-008-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **AL Engineering SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MBIKËQYRJA E INVESTIMEVE KAPITALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-363-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-008-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **22.03.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **MBIKËQYRJA E INVESTIMEVE KAPITALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-363-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-008-2-2-1**.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **AL Engineering SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MBIKËQYRJA E INVESTIMEVE KAPITALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-363-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-008-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **22.03.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **22.03.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Gjate shqyrtimit të Kerkese per Rishqyrtim jane marr analizuar pretendimet e OE „AL Engineering” shpk dhe po japim arsyeshmerin si ne vijim:

Ne letren standarde per tenderuesin e eliminuar jane dhene arsyet e eliminimit dhe tani po I shtjellojme nje nga nje.

Kerkesa 1: pika **1.5. Inxhinier i Diplomuar në Inxhinieri Makinerike ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;**

- **Dëshmitë që duhet të ofrohen për të gjitha Kërkesat 1**
- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;**
- **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;**
- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**
- **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;**

Ne materialin ofertues ju keni prezantuar z. Mehmet Zeqiraj diploma e të cilit mban Titullin: Master i Shkencave Teknike qe nuk ploteson kerkesen 1.5 ku eshte kerkuar Inxhinieri Makinerike. Arsyeshmeria qe keni dhene ne kerkesen per rishqyrtim se z Mehmet Zeqiraj se pari ka marr titullin Inxhinier i diplomuar i Makineris (e cila nuk eshte ne materialin ofertues) dhe pastaj ka vazhduar titullin akademik Master i shkencave Teknike nuk qendron. Ne praktikat e niveleve te shkollimit se pari behet gradimi Bsc. per te vazhduar me tej gradimin me Master, andaj nuk qendron konstatimi juaj po citoj „se se pari duhet graduar me titullin inxhinier i diplomuar i Makineris e pastaj ka vazhduar studimet per te marr titullim akademik Master” . Diplomat e meherhshme ne Universitetin e Prishtines qe kane graduar Inxh. te diplomuar te Makinerise ne fakultetet teknike ngjashem si Makineri, Elektrotekinik, Ndertimtari ku periudha e studimeve ka zgjatur 5 vite jane te barasvlefshme me gradimin master. Prandaj, kerkesa ne dosje ka qene e till Inxhinier Makineri apo master. Diploma e z Mehmet Zeqirja mban titullin master i shkencave teknike jo Makineri sic kerkohet ne FDT.

Kerksesa 1 Pika 1.7. Inxhinier i Diplomuar i Komunikacionit ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

- Dëshmitë që duhet të ofrohen për të gjitha Kërkesat 1
- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;
- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;

Ne materialin ofertues ju keni prezentuar z. Lek Sinani diploma e të cilit mban Titullin: Master Profesional I shkencave Mekanike Profili Transport, qe nuk ploteson kerkesen 1.7 ku eshte kerkuar **Inxhinier i Diplomuar i Komunikacionit ose master**. Arsyesmeria qe ju keni dhene ne kerkesen per rishqyrtim sa i perket pretendimit tuaj po citoj: „ në Universiteti i Prishtines Hasan Prishtina drejtimi i studimeve **Komunikacion dhe Transport** ofrohet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike’’. E vertete eshte se Fakulteti I Inxhinieris Mekanike ofron studime ne drejtimin Komunikacion por pa shtesen **dhe transport**. Fakulteti i Inxhinieris Mekanike ofron studime dhe gradon me titull: Bachelor I inxhinieris Mekanike, drejtimi Komunikacion dhe Master i shkencave te inxhinieris Mekanike, drejtimi Komunikacion. Pra, shtesen qe ju keni vendosur Transport nuk qendron. Ne kerkesat e dosjes se tenderit kemi kerkuar emertimet e gradimit qe jane te akredituar ne Republiken e Kosoves dhe nuk kemi kerkuar drejtime te akredituara ne universitete jashte vendit. Arsyesmeria qe ju jepni sa i perket vendeve te tjera si Kroaci, Maqedoni, Amerike jane jorelevante e po ashtu kontradiktore me pretendimin tuaj sepse gradimi i quajtur: „traffic and transport’’ nuk eshte i ngjashem me ate te z Lek Sinaj qe eshte vetem transport. Fjala „traffic’’ ka te beje pikerisht me komunikacion.

Diploma e nivelit Z. Leke Sina është e njohur nga Keshilli Kombetar per Njohje në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në bazë të vendimit nr 6189, date 07.05.2015. Kete veretetim ne e kemi analizaur me shume kujdes po i njeti e njeh diplomen master me titull: Master Profesional në Inxhinieri Mekanike, Profili Transport, ky vendim nuk jep asnje sqarim se ky kualifikim eshte i barazvleshem me drejtimin Komunikacion.

Kerksesa 1, Pika 1.9. Inxhinier i Diplomuar ose Bachelor në Inxhinieri Softverike (IT), me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, (i njëjti duhet të jetë i certifikuar në Cisco Certified Network Associate (CCNA));

- Dëshmitë që duhet të ofrohen për të gjitha Kërkesat 1
- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;
- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit

Dëshmitë që duhet të ofrohen për kërkesën 1.9; 1.10 ; 1.11

- Certifikata përkatëse – Kopje të noterizuar;

Ne oferten tuaj keni prezentuar z. Ardit Selimi, ka kualifikim-certifikim CISCO per IT Essential ndersa Njoftimin per Kontrate dhe dosje te Tenderit është kërkuar CISCO - Certified Network Associate (CCNA) andaj certifikimi I paraqitur nuk ploteson kërkesen e FDT-se. Gradimi IT Essential pergatite kandidatin per pune me sistemin aplikativ te Windows apo ndonje sistemi tjeter aplikativ, ndersa Gradimi CCNA eshte specific per ndertimin dhe konfigurimin e rrjetave te komunikimit dhe punes (network).

Kerksesa 1 , 1.10. Ekspert i pajisur me Certifikata rreth organizimit, menaxhimit dhe sigurisë në kantiere të ndërtimit, min. 3 vjet përvojë pune;

Ne oferten tuaj të dorëzuar, Eksperti i pajisur me Certificate rreth organizimit, Menagjimit dhe sigurisë në kantier të ndërtimit z. Dardan Demolli eshte pajisur me certificate me date 02.03.2020. Data e njoftimit per kontrate eshte 31.01.2023 dhe dorezimi i tenderit eshe bere me date 21.02.2023. Bazuar ne keto data faktike, rezulton se I njejti nuk e ka plotesuar kushtin administrative dhe material te kerkeses se pervojës se kerkur ne pike 1.10, ku kerkohet min 3 vjet pervoje pune si ekspert i certifikuar.

Sa I perket pretendimit se OE I propozuar per kontrate nuk I ploteson kriteret sipas Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 dhe 9.2, kerkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte (Mbikëqyrje të projekteve), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 120,000.00 €, ku kerkohet Dëshmia 2 Lista e projekteve te kryera në lëmin e shërbimeve të njëjte (Mbikëqyrje të projekteve), të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, dhe dëshmitë e përfundimit Referenca/t ose procesverbali/et e pranimit Teknik; ju nnjoftojme se OE ARCH EMPIRE LLC dhe ENG IDEA shpk kane ofruar deshmi te mjaftueshme se I plotesojne keto kerkesa, dhe kontratat nuk mund te perpjestohen por llogariten si tersi. Kontrata e realizuar me MPMS eshte llogaritur vetem njehere, dhe ploteson vleren e kerkuar sipas FDT. KRPP ka dhene

sqarimin nr. 10. 22.11.2022 Kurdo që kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Sa i përket dëshmime të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton: 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënenshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; Në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës. Për më shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hijezuara në këtë nën-paragraf: Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin. Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit